

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump falënderon Kosovën për kontributin me trupa në Bordin e Pages
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/politike/trump-falenderon-kosoven-per-kontributin-me-trupa-ne-i1185668
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 07:03:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d1dc751ff41f8e8f3793feb20a107a1f01f6c93444a218d9a2a2abc85d6b8276
TEKSTI	7bed2e8b8459bd3498c0b83a3d39aaa5f7d021b0593fc13d6a97bbf5689f8e21
PAMJA	2bc7f79fe62bfdc1fd708990f1a3ec698dc167f7754151b26f5fbfecb2650aa3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bc4cabfce4697032e45dfbeb027e8546f2c8e0df6a0c809dc2a07dabeaf6cc6a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bc4cabfce4697032e45dfbeb027e8546f2c8e0df6a0c809dc2a07dabeaf6cc6a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Trump falënderon Kosovën për kontributin me trupa në Bordin e Paqes

Nga A2 CNN
23 Shtator 2026, 09:03 | Politikë



Presidenti amerikan, Donald Trump, ka falënderuar Kosovën për kontributin e saj në Bordin e Paqes – nismës së udhëheqësit amerikan për arritjen e paqes në botë.

"Dua të falënderoj ato shtete që kanë vendosur të kontribuojnë me trupa, e trajnime për të stabilizuar Gazën, përfshirë Indonezinë, Marokun, Shqipërinë, Kosovën, Kazakistanin, Egjiptin, Jordaninë dhe të tjerë", tha Trump gjatë fjalimit para Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Gjatë fjalimit të tij, Trump e përmendi Kosovën dhe Serbinë edhe në kontekstin e ndaljes së një lufte, duke deklaruar se i kërcënoi këto dy shtete se do të ndalte tregtinë e tyre me SHBA-në nëse do të shpërthente lufta.

Edhe në të kaluarën, Trump ka përmendur ndaljen e një përplasjeje të mundshme mes Kosovës dhe Serbisë, përcjell A2.

Ndryshe, Kosova është në mesin e pesë shteteve të para – së bashku me Indonezinë, Marokun, Kazakistanin dhe Shqipërinë – që janë zotuar për angazhim në misionin në Gazë, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe mbikëqyrjen e armëpushimit në Rripin e Gazës.

Më 7 shtator, Kosova u bë formalisht pjesë e Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese (ISF), pasi u nënshkrua marrëveshja formale për t'u bërë pjesë e kësaj force.

Marrëveshja, e nënshkruar nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari, dhe komandanti amerikan i ISF-së, gjeneralmajor Jasper Jeffers, formalizon përfshirjen e Kosovës në forcën e planifikuar.

"Ky zhvillim i rëndësishëm nënvizon përkushtimin e Kosovës ndaj misionit të ISF-së dhe mbështetjen e saj të vazhdueshme për planin 20-pikësh për Paqe të presidentit [Donald] Trump", u tha në deklaratën e Bordit të Paqes.

Nënshkrimi të kësaj marrëveshjeje i ka paraprirë miratimi nga Kuvendi për dërgimin e FSK-së jashtë vendit dhe marrëveshjes për anëtarësim në Bordin e Paqes, si dhe autorizimit për dërgimin e tyre në Gazë nga Presidenca.

Ndërkaq, në prill një ekip i FSK-së shkoi në Rripin e Gazës për të bërë një vlerësim të vendit ku pritet të veprojnë trupat kosovare si pjesë e një force ndërkombëtare në territorin palestinez.

Forca Ndërkombëtare Stabilizuese buron nga një plan 20-pikësh i presidentit amerikan, Donald Trump, për t'i dhënë fund luftës së Izraelit në Gazë.

Trumpi krijoi Bord të Paqes për të mbikëqyrur planin e tij për t'i dhënë fund luftës së Izraelit në Gazë dhe për të rindërtuar territorin e shkatërruar.

TE FUNDIT

🔴 "Skandale të tjera" paralajmëron Gjoni: Së shpejti do dalin përgjimet ku kanë shkuar lekët e inceneratorëve

🔴 "Pse drejtoreshë ndërmarrje është ajo?!", Petraj: Rrallë ndodh në botë të jepen masa sigurie për shefat e Inteligjencës

Në kërkim për trafik ndërkombëtar kokaine, arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu

🔴 NATO ngre bombarduesit, helikopteri shkel kufirin polak, qëndron 42 sekonda

MË TË VIZITUARAT

Ndryshon ligji për pensionet private, me më shumë garanci! Mbrojtje nga falim...

Zelensky: Jemi gati për armëpushim në Detin e Zi, presim përgjigjen e Rusisë...

"Po mbrohet Vlora Hyseni", Berisha: SPAK nuk e cilëson anëtare të grupit të ...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

sipas planit, forca paqerujtese duhet te zrvendosen ne Gaze per te siguruar zonat pas tërheqjes së forcave izraelite, si dhe t'i trajnojnë forca e reja policore palestineze dhe të mbështesin dërgimin e ndihmave atje.

Pjesa më e madhe e Gazës mbetet në rrënoja pas dy vjetësh luftë, e cila u shkaktua nga sulmet e udhëhequra nga Hamasi – grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga SHBA-ja dhe BE-ja – më 7 tetor 2023.

Por, që nga njoftimi për një marrëveshje në fund të korrikut, përpjekjet për dërgimin e trupave kanë ngecur, pasi si Izraeli, ashtu edhe Hamasi nuk kanë pranuar t'i përmbushin kushtet që do ta mundësonin zbatimin e marrëveshjes./ [REL \(A2 Televizion\)](#)

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Takime të ndara me Kurtin dhe Vuçiç, Kallas kërkon përparim në dialog



E ardhmja e Gjykatës Speciale, Kusari-Lila: Duhet menduar mirë hapat e radhës



Çfarë parashikon nisma e PDK-së për ndryshime në ligjin për Specialen?



Fati i ish-krerëve të UÇK, Hamza: Presim që Apeli të vendosë mbi bazën e fakteve



PDK dorëzon në Kuvend projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, gazetarja: Gjykatësi e ka personale, që kur punonte për EULEX-in

Latest Videos



"Ergys Agasi lëvizte me makinat e SHISH" Acarohet avokati: Pse nuk i denoncuam ata që e panë?



"Skandale të tjera" Gjoni: Së shpejti do dalin përgjigjet ku kanë shkuar lekët e inceneratorëve



"O Mentor, ku e ke parë Gysin me eskortë policie?" Debat i fortë mes avokatit e Kikisë: Shihë nesër...



"Çfarë sekretesh të shtetit kanë nxjerrë?" Gjin Gjoni kërkon sqarim: Kush e detyroi Vlorën të...

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulo
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundëuar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.